

20141454532

MINISTRIA E PUNËVE TË BRENDSHME

Në bazë të nenit 55 paragrafi 1 të Ligjit për organizimin dhe funksionimin e Organeve të Administratës Shtetërore ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 58/00, 44/02, 82/08, 167/10 dhe 51/11) dhe në lidhje me nenet 24-gj dhe 24-e të Ligjit për Siguri Private ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 166/12 dhe 164/13), Ministri i Punëve të Brendshme miratoi

RREGULLORE PËR MËNYRËN E VLERËSIMIT ME PIKË TË PËRGJIGJEVE NGA PROVIMET PROFESIONALE PËR SIGURIM FIZIK DHE TEKNIK

Neni 1

Me këtë Rregullore përshkruhet mënyra e vlerësimit me pikë të përgjigjeve në pyetjet nga provimet profesionale për sigurinë fizike dhe teknike.

Neni 2

Përgjigja e saktë e pyetjes vlerësohet me një pikë, ndërsa përgjigja e ngjashme dhe përgjigja e pasaktë vlerësohen me zero pikë. Kandidati e ka kaluar lëndën nëse ai ka fituar minimum shtatë pikë pozitive prej gjithsej dhjetë pikëve për një lëndë. Numri i përgjithshëm i pikëve për një lëndë është dhjetë.

Numri total i pikave për pjesën teorike të provimit të sigurisë fizike për të gjitha lëndët është 70.

Numri total i pikëve për pjesën teorike të provimit për sigurimin teknik për të gjitha lëndët është 50.

Neni 3

Kjo Rregullore hyn në fuqi në ditën e tetë nga dita e shpalljes në "Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë" dhe do të fillojë të zbatohet më 5 dhjetor 2014.

Nr. 12.1-68278/1
29 shtator 2014
Shkup

Ministër
i Punëve të Brendshme,
m-r Gordana Jankulovska.
n.p